

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6225
E enjte, 28 janar 2021
çmimi 0.40 €

Ministri Zemaj bën
thirrje që të zbatohen
rekomandimet kundër
Covidit FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE NUK E KA PRANUAR KËRKESËN E AVOKATËVE PËR LIRIMIN
ME KUSHT TË ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

SPECIALJA REFUZON LIRIMIN E PËRKOHSHËM TË THAÇIT DHE TË TJERËVE



Gjykata Speciale ka refuzuar kërkesat e avokatëve për lirim me kusht të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, i cili veç e veç ua ka refuzuar kërkesat për lirim me kusht, ka vlerësuar se refuzimi i kërkesës për lirim e përkohshëm të Thaçit dhe të tjerëve arsyetohet me Nenin 41(6)(b) të ligjit FAQE 4-5

AKTUALE



**KOSOVA PËRKUJTON VIKTIMAT
E HOLOKAUSTIT** F. 3

**SHTYHET MBLEDHJA E DY
QEVERIVE KOSOVË - MAQEDONI
E VERIUT, SHKAK ZGJEDHJET** F. 3

**SLOGANI I NISMËS NË
ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT:
ME ÇLIRIMTARË!** F. 6

**HOXHAJ: DO TA LUFTOJMË
KRIMIN E ORGANIZUAR DHE
PASURITË E FITUARA
KUNDËRLIGJSHËM** F. 6

EKONOMI



**ABRASHI: DO TË
SUBVENCIONOHEN KOMPANITË E
TRANSPORTIT BRENDA VENDIT** F. 9

**HAZIRI E KADRIU NËNSHKRUAJNË
MEMORANDUMIN PËR EFIÇIENCË
TË ENERGJISË** F. 10

SPORT

**BAHTIRI NDERON ME
MIRËNJOHJE ANËTARËT E KLUBIT
TË ZHYTJES 'TREPÇA'** F. 12

FYERJE NË VEND TË PROGRAMEVE ZGJEDHORE

Përplasjet verbale dhe fjalori i ashpër ndërmjet partive politike po e karakterizojnë periudhën e parafushtës zgjedhore, thonë njohësit e zhvillimeve politike, Arton Demhasaj dhe Imer Mushkolaj. Përplasjet e tilla verbale ndërmjet

përfaqësuesve të subjekteve politike, sipas tyre, përmbajnë ofendime dhe fyerje qoftë nëpër rrjetet sociale, qoftë nëpër studio televizive dhe, po ashtu, edhe gjatë takimeve të përfaqësuesve të subjekteve politike me simpatizuesit e tyre



LV-ja DHE AAK-ja DORËZOJNË ANKESAT NË GJYKATËN SUPREME

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja lejon fluturimin e avionëve Boeing 737 Max

Bruksel, 27 janar - Bashkimi Evropian (BE) u ka dhënë autorizim fluturimi avionëve të pasagjerëve të tipit Boeing 737 Max, ndaj të cilëve kishte ndalesë qarkullimi për shkak

të aksidenteve fatale. Patrick Ky, drejtor i Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA), ka lëshuar për media një deklaratë me shkrim në lidhje me avionët

737 Max të prodhuesit amerikan Boeing, fluturimi i të cilëve u ndalua pas aksidenteve në vitet 2018 dhe 2019. Ai ka theksuar se kanë vendosur që 737 Max mund të

kthehet në shërbim në mënyrë të sigurt pas rishikimit të gjerë nga EASA. ShBA-ja dhe Brazili tashmë kanë lejuar fluturimet komerciale të tipit 737 Max vitin e kaluar.



Shumica e republikanëve votojnë kundër gjyqit për Trumpin



WASHINGTON, 27 JANAR - Shumica dërrmuese e republikanëve të Senatit Amerikan votuan kundër procedimit të gjyqit të ish-presidentit amerikan, Donald Trump. Kjo sinjalizon se Trumpi nuk do të dënohet mbi akuzat për nxitje të trazirave vdekjeprurëse në ndërtesën e Kongresit Amerikan më 6 janar. Në një votim procedural, vetëm pesë nga 45 senatorët republikanë iu bashkuan 50 demokratëve të Senatit, që duan ta vazhdojnë gjyqin. Votimi me 55 vota për dhe 45 kundër sugjeron se gjyqi i Trumpit ka të ngjarë të përfundojë me pafajësi. Për ta dënuar Trumpin, së paku 17 senatorë republikanë duhet

të bashkohen me të gjithë senatorët demokratë, për ta arritur shumicën minimale prej dy të tretave. Gjyqi nuk është planifikuar të fillojë deri në javën e 8 shkurtit. Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, ka votuar për shkarkimin e Trumpit pak ditë para se ai ta përfundonte mandatin presidencial më 20 janar. Në trazirat në Kongres pesë persona kanë vdekur, në mesin e tyre një zyrtar i policisë. Trumpi është akuzuar se me fjalimet e tij i ka nxitur mbështetësit ta sulmojnë dhunshëm Kongresin, në përpjekje për ta ndryshuar rezultatin zgjedhor.

'AstraZeneca' refuzon bisedimet me përfaqësuesit e BE-së


LONDËR, 27 JANAR - Prodhuesi britanik i vaksinave kundër koronavirusit, "AstraZeneca", ka refuzuar të marrë pjesë në një takim me zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian, të planifikuar për të mërkurën. "Mund të konfirmoj se për sonte kishim të planifikuar një komitet drejtues mbi strategjinë e vaksinimit dhe përfaqësuesit e 'AstraZenecas' na informuan këtë mëngjes se nuk do të

marrin pjesë", ka pohuar për gazetarët zëdhënësja e Komisionit Evropian, Dana Spinat. Kjo ndodh në kohën e përshkallëzimit të mosmarrëveshjeve midis dy palëve për shkak të mungesave të prodhimit të vaksinave nga kjo kompani.

Komisioni Evropian, në emër të shteteve anëtare të BE-së, ka nënshkruar marrëveshje me "AstraZenecan" për 400 milionë

vaksina.

Javën e kaluar kjo kompani e ka njoftuar BE-në se do të sigurojë një numër dukshëm më të vogël të vaksinave. Dyshimet se kompania po dërgon doza të vaksinës në vende të tjera, me një çmim shumë më të lartë, kanë bërë që Komisioni Evropian të vendosë për krijimin e një mekanizmi, që e ndalon eksportin e vaksinave kundër koronavirusit pa njoftim



Europoli shkatërron një rrjet të sulmeve kibernetike

HAGË, 27 JANAR - Hetuesit ndërkombëtarë kanë shkatërruar një nga softuerët më të rrezikshëm në botë që përdorej për të hakuar rrjete kompjuterike. Infrastruktura e sistemit "Emotet", e cila

përdorej kryesisht nga rrjetet e krimit të organizuar, tani është nën kontrollin e autoriteteve. Kështu ka njoftuar Agjencia e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (Europol) me seli në Hagë.

Operacioni u zhvillua pas hetimeve që zgjatën dy vjet në tetë vende. Europol nuk njoftoi për ndonjë arrestim në lidhje me hetimin, që është udhëhequr nga Gjermania dhe Holanda.

Në vitin 2020 papunësia në Francë shënoi rritje

Paris, 27 janar - Në Francë numri i personave të papunë në vitin 2020 tejkaloi 3.8 milionë. Sipas të dhënave të publikuara nga Drejtoria e Hulumtimit, Punës dhe Statistikave pranë Ministrisë

së Punës, papunësia në Francë në vitin 2020, edhe pse ra 2.7 për qind në çerekun e fundit të vitit, në krahasim me vitin 2019 ajo u rrit për 7.5 për qind. Gjatë gjithë vitit numri i personave të kategorisë "pa

asnjë punë" u rrit në 265 400 i cili çoi numrin e përgjithshëm në 3 816 700. Numri i personave që kishin punë të përkohshme me kohë të shkurtër dhe të gjatë u rrit në 2 190 200.



Liderët institucionalë kanë shënuar Ditën e Përkujtimit të Holokaustit

Kosova përkujton viktimat e holokaustit

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë nderuar viktimat e holokaustit. Në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit ata kanë bërë homazhe te pllaka përkujtimore për hebrejtë, duke u shprehur krenarë që populli shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore ka ndihmuar pjesëtarë të këtij komuniteti. Ata kanë vlerësuar se lidhjet historike ndërmjet popullit shqiptar dhe popullit hebre janë të veçanta

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 JANAR - Në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit, udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë përkujtuar miliona hebrejtë të vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ata kanë bërë homazhe dhe vendosur lule te pllaka përkujtimore për hebrejtë, e cila gjendet në oborr të qeverisë.

Ushtuesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se gjenocidi ndaj hebrejtë është barbaria më e madhe që njih historia njerëzore deri më sot. "Nuk mund ta njohë askush më shumë dhimbjen sesa popujt që përjetuan fate historike të ngjashme. Në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit,

bashkëndiejmë me miqtë tanë dhe ritheksojmë se gjenocidi ndaj hebrejtë është barbaria më e madhe që njih historia njerëzore deri më sot. Sot duhet ta kujtojmë dhe të ndihemi krenarë për ndihmën të cilën shqiptarët i dhanë komunitetit hebraik në vitet e trishtimit. E përderisa kujtojmë kalvarin e hebrejtë, nuk ka si të mos përmendet edhe ndihma e shtetit izraelit ndaj kosovarëve të dëbuar dhunshëm në luftën e vitit 1999", ka shkruar Osmani në profilin e saj në "Facebook". Ajo ka thënë se Kosova dhe Izraeli kanë ndërtuar ura të miqësisë. "Në botë mbijetojnë vetëm miqësitë ndërmjet popujve e shteteve. Kosova, shqiptarët, Izraeli dhe izraelitët prej kohësh kanë ndërtuar urat e miqësisë. Holokausti u kujtoftë përgjithmonë dhe

shërbeftë në funksion të ndërgjegjësimit që ngjarjet si këto të mos ndodhin kurrë më! Përkujtimi i Holokaustit është riafirmim i të vërtetës, një nevojë prej së cilës nuk duhet të hiqet dorë asnjëherë dhe në asnjë rrethanë!", ka shkruar ajo. Edhe kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë homazhe te pllaka

përkujtimore për hebrejtë. "Besoj se populli shqiptar është populli që më së miri e kupton popullin hebraik dhe bashkëndien me vuajtjet që ka pasur gjatë historisë. Unë jam krenar që si popull shqiptar, gjatë periudhës më të vështirë të Luftës së Dytë Botërore, kemi ndihmuar pjesëtarë të këtij komuniteti, të gjejmë strehim në Kosovë dhe Shqipëri. Kjo tregon përkushtimin e familjeve shqiptare për t'i dalë në ndihmë këtij populli në momentet më të vështira", ka thënë Hoti.

Ndërsa kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se lidhjet historike ndërmjet popullit shqiptar dhe popullit hebre janë të veçanta. "Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit kujtojmë vuajtjet e sakrificat e popullit hebraik. Dhembjen e tyre e ndiejmë më së miri ne që kemi përjetuar edhe vetë okupimin e egër dhe gjenocidin. Shqiptarët hapën dyert për hebrejtë në kohët më të vështira të mbijetesës së tyre. Lidhjet historike ndërmjet popullit shqiptar dhe popullit hebre janë të veçanta. Ato do të ruhen e kultivohen edhe më tepër në të gjitha nivelet. Njohja e

Kosovës nga Izraeli ka hapur dyert për thellimin dhe avancimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve e popujve", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit, edhe Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" ka përkujtuar gjenocidin që regjimi nazist kreu kundër popullit hebre. Përmes një njoftimi për media, kjo qendër ka shprehur dhembjen e saj për të gjitha viktimat e këtij gjenocidi, duke kërkuar që bota ta njohë gjenocidin serb në Kosovë. "Duke qenë tërësisht me dhembjen e popullit hebre në këtë ditë përkujtimi të çlirimit të Kampit të Aushvicit dhe zbulimit të tmerreve që fshiheshin në këtë kamp, Qendra 'Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur' kërkon që të njihet nga të gjitha shtetet e botës tragjedia që ka përjetuar populli shqiptar i Kosovës dhe të ndëshkohet gjenocidi që ka kryer Serbia", është thënë në njoftimin e kësaj qendre.

Holokausti ishte një prej kapitujve më të errët të Luftës së Dytë Botërore, kur në kampet e përqendrimit gjatë përndjekjes sistematike dhe çnjerëzore u shfarosën miliona hebrejtë.



Shtyhet mbledhja e dy qeverive Kosovë - Maqedoni e Veriut, shkak zgjedhjet

SHKUP, 27 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës së Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj. Ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në këtë takim me ambasadorin Dedaj kanë diskutuar për zgjedhjet që do të mbahen në Kosovë më 14 shkurt dhe për

ish-drejtuesit e UÇK-së të cilët janë në Hagë. Në këtë takim është konfirmuar edhe shtyrja e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive Kosovë - Maqedoni e Veriut. "Sot pata kënaqësinë që të pres në takim pune ambasadorin e Republikës së Kosovës, z. Gjergj Dedaj. Dedaj i thashë se uroj që në Kosovë më 14 shkurt të mbahen zgjedhje të lira e demokratike dhe zgjedhje të institucioneve

në Kosovë që sa më parë të mund të vijojë mbajtja e mbledhjes së përbashkët e dy qeverive tona. Gjithashtu, ambasadorit Dedaj i shpreha përkrahje për procesin e ish-drejtuesve të Republikës së Kosovës të cilët për momentin janë në Hagë. I thashë që shpresoj se ata do të kthehen faqebardhë dhe që drejtësia çdoherë ngadhënjën dhe del në dritë", ka shkruar Grubi.





GJYKATA SPECIALE NUK E KA PRANUAR KËRKESËN E AVOKATËVE PËR LIRIMIN ME KUSHT TË ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

Në vend të programeve zgjedhore, fyerje

Përplasjet verbale dhe fjalori i ashpër ndërmjet partive politike po e karakterizojnë periudhën e parafushatës zgjedhore, thonë njohësit e zhvillimeve politike, Arton Demhasaj dhe Imer Mushkolaj. Përplasjet e tilla verbale ndërmjet përfaqësuesve të subjekteve politike, sipas tyre, përmbajnë ofendime dhe fyerje qoftë nëpër rrjete sociale, qoftë nëpër studio televizive dhe, po ashtu, edhe gjatë takimeve të përfaqësuesve të subjekteve politike me simpatizuesit e tyre

PRISHTINË, 27 JANAR - Arton Demhasaj, drejtor i Organizatës për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet - Çohu, ka thënë se subjektet politike i janë qasur kësaj forme të fushatës joformale në vend se qytetarëve t'u shpalosin programet dhe platformat me të cilat garojnë për të ulëset në Kuvendin e Kosovës dhe për qeverinë e re. "Në momentin që ato (subjektet politike) dalin e takojnë dhe grumbullojnë njerëz, si dhe realizojnë një lloj fushate, mendoj se është dashur që të kenë programe të shkruara dhe të artikuluar mirë. Kur të takohen me njerëz, thjesht, t'u tregojnë se cili është vizioni i tyre politik dhe se çfarë parashohin ato të bëjnë. Por, këtë gjë nuk po e shohim.

Sidoqoftë, mendoj se është dashur të anashkalohen çështjet që po bëhen shumë publike, të sharjeve ndërpartiake dhe gjërat e tilla, duke i sulmuar edhe institucionet e pavarura, gjë që po ndodh fatkeqësisht", ka theksuar Demhasaj për "Radion Evropa e Lirë".

Njohësi i çështjeve politike, Imer Mushkolaj, në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë" thotë se sjellja që subjektet politike manifestojnë aktualisht, me fjalor të ashpër dhe në shumë raste fyes në adresë të njëra-tjetrës, nuk është e rastësishme. Sipas tij, të gjitha subjektet politike i kanë indikacionet lidhur me mbështetjen që e kanë në elektorat. "Varësisht prej këtyre indikacioneve, pastaj gjithë këtë

mlllef ose këtë pakënaqësi, përpiqen që ta përkthejnë ose transmetojnë në publik përmes një gjuhe, shpeshherë jashtëzakonisht problematike, përballë rivalëve politikë dhe jo vetëm ndaj tyre. Nuk është se edhe në parafushatat dhe fushatat e kaluara nuk ka ekzistuar kjo gjuhë e partive politike ose njerëzve të politike, por kësaj radhe kam përshtypjen se është më e shprehur", ka deklaruar Mushkolaj. Ai shtoi se subjektet politike janë duke e shfrytëzuar, siç e quan ai, parafushatën, për t'i nxitur militantët e tyre për të bërë tifo për partitë që pasojnë, por pa u ofruar programe të qarta as atyre dhe as qytetarëve në përgjithësi, se çfarë synojnë të bëjnë nëse vijnë në pushtet.

Riciklim i programeve dhe premtimeve

Të dy këta njohës të zhvillimeve politike thonë se deri më tash subjektet politike nuk i kanë shpalosur programet me të cilat garojnë në zgjedhje, por vetëm siç i quajnë ata, inserte apo copëza programesh, të cilat, në fakt, nuk kanë përmbajtje të re nga programet e tyre në zgjedhjet paraprake. Në të shumtën e rasteve, siç thonë ata, bëhet fjalë për riciklim të premtimeve dhe programeve, por të cilat publiku ende nuk ka arritur t'i shohë plotësisht. Sipas tyre, programet vetëm janë freskuar me disa ide për situatën nëpër të cilën po kalon vendi me pandeminë dhe me zhvillimin ekonomik e social. Lëvizja Vetëvendosje deri më tash nuk i ka shpalosur ofertat e saj për qytetarët, në formë programi, por në takimet me qytetarët në rajone dhe qytete të ndryshme të vendit ka garantuar përkrahjen për ta dhe për adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohen ata. Kjo parti ka premtuar zhvillim ekonomik që krijon vende të reja

të punës, si dhe drejtësi institucionale dhe shoqërore.

Megjithatë, Lidhja Demokratike e Kosovës, përmes kandidatit të saj për kryeministër, Avdullah Hotit, më 25 janar ka shpaluar programin e saj të cilin ua oferton votuesve. Prioritetet që janë në fokus të LDK-së, sipas Hotit, janë lufta kundër pandemisë së koronavirusit, integrimet euroatlantike, mirëqenia e qytetarëve, sundimi i ligjit e të tjera.

Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë më 25 janar, përmes një spoti parazgjedhor, se në fokusin e kësaj partie do të jetë sundimi i ligjit dhe i sigurisë, rimëkëmbja e vendit në fushën e ekonomisë dhe atë shëndetësisë.

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tashmë ka shpalosur ambicien e tij për t'u zgjedhur president, pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Ai ka paralajmëruar angazhimin për forcimin e rendit dhe ligjit, policisë dhe ushtrisë, reformë në

Specialja refuzon lirimin e përkohshëm të Thaçit dhe të tjerëve

Gjykata Speciale ka refuzuar kërkesat e avokatëve për lirimin me kusht të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, i cili veç e veç ua ka refuzuar kërkesat për lirim me kusht, ka vlerësuar se refuzimi i kërkesës për lirimin e përkohshëm të Thaçit dhe të tjerëve arsyetohet me Nenin 41(6)(b) të ligjit

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 JANAR - Gjykata Speciale nuk e ka pranuar kërkesën e avokatëve për lirimin me kusht të ish-krerëve të UÇK-së. Gjykatësi i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Hagës, Nicolas Guillou, ka vendosur që Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi të mbesin në paraburgim. Në njoftimin e lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës, thuhet se refuzimi i kërkesës për lirimin e përkohshëm të Thaçit dhe të tjerëve arsyetohet me Nenin

41(6)(b) të ligjit.

Ky nen, mes të tjerash, përfshin: rrezikun nga arratisja, rrezikun nga shkatërrimi, fshehja, ndryshimi ose falsifikimi i provave, si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Në parashtrësat e kryeprokurorit special, Jack Smith, janë renditur disa arsyeje se pse ish-krerët e UÇK-së, sipas organit të akuzës, duhet të vazhdojnë të qëndrojnë në paraburgim. Prokuroria ka përmendur edhe mundësinë e dënimit të disa prej tyre me burgim të përjetshëm, si një prej arsyeve se pse, sipas tyre, ata nuk duhet të lirohen as përkohësisht.

Smith në të gjitha parashtrësat ka pretenduar se ekziston rreziku që ish-pjesëtarët e UÇK-së të arratisen, të ndikojnë në dëshmitarë ose ta kryejnë ndonjë krim. Ndër të tjera, organi i akuzës në Hagë ka pretenduar se kriteret për t'i mbajtur në paraburgim ish-krerët e UÇK-së janë përmbushur dhe se këto kriteret "nënvizojnë seriozitetin e rreziqeve të paraqitura". Sipas prokurorisë, "asnjë masë alternative nuk adreson sa duhet këto rreziqe". Prokuroria në parashtrësat kundër të akuzuarve, po ashtu, thekson pretendimin e saj se ekziston një klimë e frikësimit të dëshmitarëve

në Kosovë, të cilët thuhet se ish-krerët e UÇK-së kanë mundësi që t'i heshnin.

ZPS-ja është ankuar se si organ i akuzës nuk kanë burime për t'i mbikëqyrur ish-krerët e UÇK-së nëse ata do të liroheshin përkohësisht. Gjithashtu, është përmendur edhe mandati i EULEX-it, ndërsa kryeprokurori Smith ka konsideruar se "autoritetet e Kosovës janë të kufizuara në aftësinë e tyre për ta mbikëqyrur një të akuzuar". Thaçi, Veseli, Selimi, Krasniqi, ndodhen në objektet e paraburgimit në Hagë qysh në fillim të nëntorit të vitit të kaluar, kur u është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe kanë udhëtuar për në Hagë. Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka paraqitur kërkesën për lirim të përkohshëm qysh në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar. Përpara tyre është arrestuar dhe dërguar në Hagë edhe Salih Mustafa, ish-epor i UÇK-së.

Aktakuza e ngarkon atë për kryerje të krimeve të luftës.

Në paraburgim në Hagë gjenden edhe dy krerë të OVL-së së UÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj. Ndryshe nga të tjerët, të cilët akuzohen për krime lufte, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. Të gjithë këta ish-eporë të UÇK-së në seancat gjyqësore, ku u është lexuar aktakuza, janë deklaruar të pafajshëm. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.



sistemin arsimor, krijimin e një fondi për financimin e punësimit të parë të rinjve. Haradinaj ka thënë, gjithashtu, që në rast se Kosova mbetet vend i izoluar, atëherë opsioni tjetër për Kosovën do të jetë një referendum për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Skena politike, e përçarë; fjalori, nxitës për militantët partiakë

Arton Demhasaj thotë se fjalori i ashpër dhe fyes, me të cilin

subjektet politike sulmojnë njëra-tjetrën, mund të jetë i kuptueshëm gjatë fushatës zgjedhore por, sipas tij, ai nuk ndërlihet vetëm me fushatën. "Skena politike është shumë e përçarë dhe shumë e polarizuar. Është në një fazë goxha të rrezikshme që e gjithë kjo pastaj mund të transferohet edhe në shoqëri. Ky acarim që po shfaqet edhe përmes mediave, në mes partive politike, mund të ndikojë te qytetarët. Prandaj, mendoj se partitë politike duhet të jenë shumë të kujdesshme në fjalorin

që e përdorin dhe që të mos kenë tendenca që t'i nxitin edhe militantët e tyre partiakë, gjë që mund të shpërfaqet në ndonjë konflikt të ndërsjellë të militantëve të partive politike. Fatmirësia në fatkeqësi është që jemi në pandemi dhe nuk do të ketë grumbullime të mëdha. Përndryshe do të ishte rrezik, marrë parasysh se sa e polarizuar dhe sa e acaruar është skena politike", ka theksuar Demhasaj. Edhe Imer Mushkolaj vlerëson se subjektet politike tashmë e kanë idenë për fuqinë politike që

prezantojnë dhe mundësitë që kanë për t'i fituar ose jo zgjedhjet. Sipas tij, pikërisht kjo është arsyeja pse ato nuk kursehen për përdorimin e fjalorit të ashpër. Por, sipas tij, përdorimi i këtij fjalori të ashpër mund të çojë në përplasje më të mëdha jo vetëm ndërmjet rivalëve politikë, por edhe ndërmjet militantëve dhe përkrahësve të partive politike. "Tash lufta ose beteja më e madhe zhvillohet edhe në rrjetet sociale, me një gjuhë krejtësisht të papranueshme, në mes njerëzve që përkrahin një parti ose një tjetër,

duke e kontaminuar jashtëzakonisht shumë hapësirën publike. Këtë hapësirë publike ata po e zhvillojnë për goditje të ulëta ndaj njëri-tjetrit, në vend se ta shfrytëzojnë si platformë, për krahasimin e ofertave politike dhe programeve politike", është shprehur Mushkolaj. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen më 14 shkurt. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, subjektet politike do të kenë 10 ditë për fushatë zgjedhore, nga 3 shkurti deri më 12 shkurt.

Hoti zhvillon bisedë telefonike me Kurzin, rikonfirmohet përkrahja e Austrisë

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka zhvilluar një takim virtual me kancelarin Federal të Austrisë, Sebastian Kurz, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale politike, për menaxhimin e pandemisë Covid-19, për shpërndarjen e vaksinave, për procesin e liberalizimit të vizave, si dhe për bashkëpunimin bilateral. Kryeministri Hoti e njoftoi kancelarin Kurz me zhvillimet aktuale dhe punën e qeverisë në detyrë, e cila po i kryen të gjitha obligimet në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën e vendit.

Kryeministri Hoti me kancelarin Kurz bisedoi edhe për përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Hoti e njoftoi kancelarin Kurz me masat që ka ndërmarrë qeveria për minimizimin e pasojave që ka shkaktuar pandemia si në aspektin shëndetësor, po ashtu edhe në atë ekonomik e social. Derisa po bisedonin për procesin e imunizimit dhe të vaksinimit kundër Covid-19, kryeministri Hoti nga kancelari Kurz mori konfirmimin se shpërndarja e vaksinave për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëhet në të njëjtën kohë.

Hoti me Kurzin bisedoi edhe për procesin e liberalizimit të vizave, ku mori mbështetjen e tij për vazhdimin e punës së mirë të qeverisë, në mirëmbajtjen e kriterëve të plotësuar për liberalizim në mënyrë që edhe qytetarët e Kosovës sa më parë të mund të lëvizin lirshëm në zonën Shengen.

Me kërkesë të kryeministrit Hoti, kancelari Kurz konfirmoi se Austria do ta konsiderojë vazhdimin e marrëveshjes për kredi të butë me Kosovën, kryesisht për projekte për furnizim me ujë dhe trajtim të ujrave të zeza.



Hoxhaj: Do ta luftojmë krimin e organizuar dhe pasuritë e fituara kundërligjshëm

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, së bashku me kandidatin për deputet, Abelard Tahiri, të mërkurën janë takuar me studentët e dalluar të Fakultetit Juridik, para të cilëve kanë paraqitur planin e PDK-së për sigurinë dhe drejtësinë. Hoxhaj ka vlerësuar se data 14 shkurt do të jetë vendimtare për fillimin e planit të luftës kundër krimin të organizuar, në veçanti konfiskimit të pasurisë së fituar me aktivitet kriminal. Madje, sipas kësaj partie, në këto zgjedhje janë dy koncepte, ajo



që respekton institucionet e pavarura të Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, e cila i linçon këto të fundit. "Nuk ka

shtet të suksesshëm dhe funksional pa sundim të ligjit. Nuk ka as demokraci dhe as shtet pa sundim të ligjit. Dhe në këto zgjedhje ka dy koncepte, një koncept i cili e respekton sundimin e ligjit, i cili e respekton ligjet e Kosovës dhe institucionet e pavarura të Kosovës. Dhe një koncept tjetër nga LV-ja, e cila i linçon institucionet e pavarura të Kosovës, e cila nuk e respekton sundimin e ligjit dhe e cila është e interesuar që ta përmbysë sistemin tonë juridik dhe politik në Kosovë", ka thënë ai. Ndërsa Abelard Tahiri ka theksuar se programi i PDK-së në fushën e drejtësisë do të japë

rezultate konkrete në luftën kundër krimin të organizuar. "Deklaruam edhe konceptin e ri të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, mënyrën e verifikimit të pasurisë së tyre. Në mënyrë që të mos lejojmë kurrfarë abuzimi me paranë publike dhe çështje të tjera, po ashtu edhe aspektin e përmirësimit, ndryshimit të drejtësisë penale, e cila mundëson ndjekje efektive të të korruptuarve, kriminelëve, trafikantëve, atyre që merren me fajde dhe haraç. Pra, ne kemi një angazhim konkret të cilin sot e paraqitëm para studentëve të Fakultetit Juridik", ka thënë ai.

Slogani i Nismës në zgjedhjet e 14 shkurtit: Me çlirimtarët!



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zbuluar sloganin e partisë për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Me çlirimtarët" është slogani zyrtar i Nismës. Në përshkrimin e Limajt në "Facebook", ku është vendosur slogani, thuhet se UÇK-ja nuk

është e kaluara, por është themeli i shtetit. "UÇK-ja nuk është e kaluara. Është themeli i shtetit. Ne jemi krenar me këtë trashëgimi dhe do ta mbrojmë atë. Me çlirimtarët - këta jemi ne, kjo është ajo që na definojnë!", ka shkruar Limaj. Lideri i Nismës angazhimin politik të mërkurën e ka

vazhduar në qytetin e Ferizajt. Limaj ka mbajtur një takim me të rinjtë e Lagjes "12 qershori". "Jam tejet i lumtur që kjo gjeneratë e artë e shoqërisë sonë, me vullnet e përkushtim po i bashkohet kauzës sonë të drejtë, duke u rreshtuar me çlirimtarët për vlerat kombëtare", ka thënë Limaj.

Komisioni për Politikë Ndëshkimore drejt finalizimit të udhëzuesit për veprat penale të korrupsionit

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Gjykatës Supreme, Enver Peci, është mbajtur takimi virtual i Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore. Anëtarët e komisionit janë njoftuar me Udhëzuesin e miratuar nga Kryeprokurori i Shtetit, për rolin e prokurorit në politikën ndëshkimore, ndërkaq ekspertja e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Benina

Kusari, ka paraqitur një përmbledhje të draft Udhëzuesit për veprat penale të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Anëtarët e Komisionit diskutuan rreth këtij draft Udhëzuesi dhe u pajtuan që komentet plotësuese t'i përcjellin brenda javës. Sipas kreut të Supremes, zbatimi i këtyre udhëzuesve, përveç që ua lehtëson gjyqtarëve vendosjen sipas ligjit, do të ndikojë në

konsistencën në dënime, e cila ende lë për të dëshiruar. Gjatë këtij takimi kryesuesi Peci ka paraqitur anëtarin e re të komisionit nga Gjykata Themelore e Prishtinës, gjyqtaren Albina Shabani. Kryetari falënderoi Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe UNDP për mbështetjen e vazhdueshme për Komisionin Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.



LV-ja dhe AAK-ja dorëzojnë ankesat në Gjykatën Supreme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë dorëzuar në Gjykatën Supreme ankesat në lidhje me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për të mos certifikuar kandidatët për deputetë që kanë pasur probleme me ligjin.

Blerim Sallahu, përfaqësues ligjor i Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se "PZAP-i deklaroi pa asnjë bazë kushtetuese se neni 29 paragrafi, 1 pika q, është normë kushtetuese, dhe ju e dini se amendamentet kushtetuese bëhen në Kuvendin e Kosovës. Kjo është çështje ligjore dhe nuk është kushtetuese".

Edhe AAK-ja e ka dërguar në Gjykatën Supreme ankesën lidhur me vendimin e PZAP-it në lidhje me moscertifikimin e kandidatëve. Në vendimet e publikuara të martën, PZAP-i ka njoftuar se ka refuzuar pjesërisht apelin e Lëvizjes Vetëvendosje. Ky organ ka vërtetuar vendimin e

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për moscertifikimin e pesë kandidatëve për deputetë të kësaj partie: Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Liburn Aliu, Bajram Mavriqi dhe Labinotë Demi-Murtezi.

Më 3 janar 2018, deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, u dënuan me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Në shtator të po atij viti, Gjykata e Apelit i ka vërtetuar dënimet e shqiptuara nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Paneli, po ashtu, ka vendosur që Nisma Socialdemokrate të certifikohet si parti politike për zgjedhjet e 14 shkurtit, por ka refuzuar kërkesën për certifikimin e 12 kandidatëve për deputetë: Vesel Krasniqi, Besnik Berisha, Filloreta Bytyçi, Valentina Alijaja, Xhafer Berisha, Aziz Thaçi, Musa Fetahaj, Hasime Daka, Fatmir Gërdellaj, Vehbi Avdullahaj, Endrit Shala dhe Adrian Nokaj.

Si në rastin e LV-së, edhe për



Nismën Socialdemokrate, PZAP-i ka refuzuar rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, që kishte dërguar në KQZ me rekomandimin që kandidatët që kanë probleme me ligjin, të certifikohen për zgjedhje. PZAP-i ka njoftuar se edhe kandidatët e Nismës që janë cekur në vendim nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë.

Vendimi i njëjtë vlen edhe për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, ku PZAP-i ka thënë se kandidatët për deputetë: Shemsedin Dreshaj, Gani Dreshaj, Rrahim Ajeti dhe Shqipe Kastrati nuk mund të certifikohen dhe as të

zëvendësohen me kandidatë të tjerë.

Ndërkaq, kandidatët e tjerë në listën për garë zgjedhore të këtij subjekti do të certifikohen për zgjedhjet e 14 shkurtit. Në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve votoi për të mos certifikuar listat me kandidatë për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate dhe disa parti të komuniteteve joshumicë. Në këtë mbledhje, Nisma Socialdemokrate nuk u certifikua as si parti.

Ky vendim i KQZ-së nxiti reagime të shumta të partive politike, pasi

vetë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte rekomanduar që të certifikohen listat zgjedhore të të gjitha partive. Gjatë seancës së 22 janarit, anëtarët e KQZ-së miratuan listat me kandidatë që nuk ishin ndesh me ligjin apo të atyre partive, që kishin zëvendësuar emrat në listat e tyre pas verifikimit të kryer nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të publikuar dhjetorin e kaluar lidhur me zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, të drejtuar nga Avdullah Hoti, KQZ-ja ka ndërmarrë një proces të verifikimit të kandidatëve për deputetë, për të parë nëse ata nuk kanë probleme me ligjin. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në një përgjigje dërguar KQZ-së më herët gjatë këtij muaji, ka thënë se 47 kandidatë për deputetë kanë probleme me ligjin.

Aktgjykimi i Kushtetueses, por edhe neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, thotë se kandidat për deputet nuk mund të jetë një person, i cili gjatë tri vjetëve të fundit ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë.

Ministri Zemaj bën thirrje që të zbatohen rekomandimet kundër Covidit



Të mërkurën në Kosovë janë shënuar edhe tetë viktima nga Covid-19, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të vdekurve në 1 479. Në raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) thuhet se nga testimi i 2 325 mostrave, pozitivë me Covid-19 kanë rezultuar edhe 301 persona. Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka kërkuar nga secili që ta ruajmë shëndetin e njëri-tjetrit dhe shëndetin publik

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 325 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren,

prej të cilave kanë rezultuar 301 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Deçan një rast (91 vjeç), Gjakovë një rast (75 vjeç), Gjilan një rast (85 vjeç), Malishevë një rast (82 vjeç), Obiliq një rast (70 vjeç), Prishtinë një rast (61 vjeç), Skenderaj një rast (74 vjeç) dhe Vushtrri një rast (54 vjeç). Numri total i rasteve

pozitive është 58 988 raste nga 225 830 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 479 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 181 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve deri më sot është gjithsej 51 518 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 991.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 127 raste, Ferizaj 19 raste, Podujevë 18 raste, Gjakovë 16 raste, Suharekë 16 raste, Pejë 15 raste, Malishevë 14 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Lipjan 13 raste, Prizren 11 raste, Dragash 5 raste, Kaçanik 5 raste, Klinë 5 raste, Obiliq 5 raste, Rahovec 3 raste, Vushtrri 3 raste, Drenas 2 raste, Gjilan 2 raste, Mitrovicë 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Graçanicë, Istog, Junik dhe Shtërpçë.

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se të mërkurën kemi pasur numrin më të madh të testimeve. Ai ka kërkuar nga secili që ta ruajmë shëndetin e njëri-tjetrit dhe shëndetin publik sepse, sipas tij, ngarkesat në spitale janë rrezik i shtuar edhe për profesionistët për të ofruar përkujdesje, edhe për pacientët dhe familjet të cilat presin përkujdesje cilësore shëndetësore. "Ju bëj ftesë të gjithë qytetarëve t'i zbatojnë rekomandimet për luftimin e Covid-19", ka thënë Zemaj.

Hoti takon sindikalistët, thotë se punëtorët do të paguhen për angazhimin shtesë dhe për rrezikshmërinë

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të mërkurën takim me përfaqësuesit e sindikatave dhe shoqatave të disa institucioneve të Kosovës. Me këtë rast, Hoti, pasi ka dëgjuar ankesat dhe kërkesat e tyre, ka shprehur gatishmërinë që t'i trajtojë të gjitha kërkesat veçmas dhe për t'i parë mundësitë buxhetore për përmbushjen e tyre



Gastronomia, hoteleria dhe transporti i udhëtarëve, më të prekurit nga masat kundër pandemisë Covid-19

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën edhe përfaqësuesit e Sindikatës së Transportit Rrugor të Udhëtarëve dhe Odën e Hotelierisë dhe Turizmit, me të

cilët ka biseduar për pakon e mbështetjes financiare si pjesë e programit për rimëkëmbjen ekonomike për vitin 2021. Derisa u zotua se do t'i shqyrtojë kërkesat e këtyre dy sektorëve, kryeministri Hoti ka thënë se gastronomia, hoteleria dhe transporti i udhëtarëve janë ndër sektorët më të prekur nga vendimet e qeverisë për masat për parandalimin e pandemisë

Covid-19.

Kryeministri Hoti ka theksuar se për subvencionimin e gastronomisë, sallave të dasmave, sallave të sportit, qendrave rehabilituese dhe të ngjashme, qeveria ka ndarë 3 milionë euro në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2021, në shumën e përgjithshme prej 222 milionë eurosh.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar takim me përfaqësuesit e Sindikatës së Judikaturës, Shërbimit Korrektues, Punonjësve Socialë, Sindikatës së Policisë, ata të Zjarrfikësve, Sindikatës së Shërbimit Korrektues, Administratës së Pavarur, Sindikatës së Shërbimit Civil, ata të punëtorëve të ATK-së dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Infermierëve. Sindikalistët paraqiten një varg kërkesash bashkë me shqetësimin e tyre, se qasja e institucioneve nuk ka qenë e barabartë për secilin sektor, duke

theksuar se ata po ndihen të anshkaluar dhe të diskriminuar. Hoti, pasi ka dëgjuar ankesat dhe kërkesat e sindikalistëve, ka shprehur gatishmërinë që t'i trajtojë të gjitha kërkesat veçmas dhe për t'i parë mundësitë buxhetore për përmbushjen e tyre. Ai u zotua para përfaqësuesve të sindikatave se qeveria në detyrë do t'i paguajë të gjithë sektorët ku ka pasur angazhim shtesë dhe rrezikshmëri në punë për shkak të pandemisë Covid-19. Hoti ka deklaruar se shumica e kërkesave të sindikalistëve do të gjejnë zgjidhje me Ligjin e Pagave, i cili ka qenë i gatshëm për debat publik qysh në tetor, por janë shtyrë procedurat për shkak të pandemisë.

Të gjitha rrugët janë të kalueshme, në disa prej tyre ka pasur intervenime



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Duke u bazuar në të dhënat e ekipeve të mirëmbajtjes së rrugëve, Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se të gjitha rrugët nacionale, rajonale dhe autoudhët janë të kalueshme. Sipas MI-së, në disa prej rrugëve ka pasur intervenime për shkak të reshjeve të borës.

Në të gjitha rrugët nën përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës ka pasur intervenime me kripë dhe largimin e borës në Gjilani 1 dhe 2, Prishtina 1 dhe 2, autoudhët R7, N9, R6, Ferizaj 1 dhe 2, Gjakova 1 dhe 2, Peja 1 dhe 2, Prizreni 1 dhe 2, Mitrovica 1 dhe 2. Për shkak të

reshjeve të borës të kohëpaskohshme në 24-orëshin e fundit dhe temperaturave nën zero u intervenua disa herë me kripë si dhe pastrim të borës në autoudhën R6 Segmenti Doganaj - Hani i Elezit. Ndërsa për shkak të ngricave po intervenohet për shpërndarjen e

kripës në të gjitha rrugët e regjionit të Prizrenit 2, M25 Prizren - Morinë, R115 Prizren - Prevallë, R113 Zhur - Dragash - Restelicë, R114 Dragash - Brod, R222 Brezne - Zhur. Peja është një nga komunat që ka pasur reshje më të mëdha të borës dhe është intervenuar në vazhdimësi për t'i mbajtur rrugët e

qarkullueshme.

Në rrugën N9 Pejë - Bogë është bërë largimi i borës nga rruga me hedhëse (frezë) pasi sasia e borës ka qenë e madhe dhe ka filluar ngushtimi i rrugës. "Është bërë shpërndarja e kripës kundër ngricave. Të gjitha rrugët janë të kalueshme për qarkullim", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

Abrashi: Do të subvencionohen kompanitë e transportit brenda vendit

Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka thënë se do të subvencionohen kompanitë e transportit që janë të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës për kilometrat e kaluara brenda vendit, mirëpo për ato që kanë operuar jashtë vendit, sipas Abrashit, ende s'është vendosur. "Janë përmendur edhe linjat rajonale dhe ndërkombëtare që me qenë të drejtpërdrejta, por do të shohim më tutje se çfarë do të bëhet me ato jashtë vendit", u shpreh Abrashi

ndihmojë këto kompani për lirim të pagesave gjatë rrugëtimit të tyre. "Nesër do të kemi një marrëveshje mbi parimet dhe më pas takime të tjera", u shpreh ai.

Abrashi ka deklaruar se bëhet fjalë për subvencionimin e 400 kompanive. "Po flasim për mbi 400 kompani që operojnë me veprimtarinë e tyre dhe kanë lidhje ndërrubane", u shpreh ai. I pyetur lidhur me përcaktimin e kilometrave të transportit edhe për linjat jashtë vendit, Abrashi ka thënë që kilometrat e kaluar nga kompanitë kanë bërë që të subvencionohen të gjitha kompanitë apo operatorë të cilat janë të licencuar në të gjithë qytetet e Kosovës.

Mirëpo për ato që kanë operuar jashtë vendit, sipas Abrashit, akoma s'është vendosur. "Janë përmendur edhe linjat rajonale dhe ndërkombëtare, që me qenë të drejtpërdrejta, por do të shohim më tutje se çfarë do të bëhet me ato jashtë vendit", u shpreh Abrashi.

Kurse kryetari i Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve, Ruzhdi Kurtishaj, ka deklaruar se është e domosdoshme që këto kompani të kenë ndihmesa. "Patjetër që këto kompani duhet të ndihmohen dhe të arrijnë të mbijetojnë", ka thënë Kurtishaj, duke shtuar se Kosova ka nevojë për zhvillimin e turizmit dhe duhet të punohet mbi bazën e profesionalizmit dhe jopartiake.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 JANAR - Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Arban Abrashi, së bashku me përfaqësuesit e Shoqatës së Transportuesve Rrugorë, kanë mbajtur një konferencë për media, ku kanë konfirmuar

pajtimin e tyre që të subvencionohen kompanitë e transportit rrugor brenda vendit, ndërsa për linjat ndërkombëtare ende nuk ka ndonjë vendim por, sipas tyre, do të merren vesh në ditët në vijim edhe për këtë.

Abrashi në një konferencë për media ka thënë se së bashku me

Shoqatën e Transportit Rrugor pandemia ka ndikuar dukshëm te kompanitë që kanë bërë transportin e udhëtarëve. "Në kuadër të mundësive buxhetore të vitit 2020 që kemi pasur ne kemi bërë disa lirime të pagesave", u shpreh Abrashi.

Më tutje, ai ka thënë se e kanë hartuar një kornizë e cila do t'i



Abrashi dhe Muhaxheri nënshkruan memorandum bashkëpunimi për investime në Pejë

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Arban Abrashi, dhe kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për financimin e disa projekteve të rëndësishme infrastrukturore në këtë komunë. Abrashi ka deklaruar se investimet infrastrukturore në Pejë do të shërbejnë më së shumti për zhvillimin e turizmit, duke lidhur fshatrat e kësaj komune në mes vete. Ai theksoi se kompletimi i infrastrukturës së komunave ka ndikim në zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, duke krijuar edhe vende të reja të punës. Ndërsa kryetari i Pejës,

Gazmend Muhaxheri, ka thënë se memorandum i nënshkruar sot ka një mori përfitimesh për zhvillimin e komunës, veçanërisht në rritjen e turizmit. Muhaxheri u shpreh se realizimi i këtyre projekteve ka qenë më se i nevojshëm për Pejë, duke përmirësuar edhe më shumë infrastrukturën rrugore.

Memorandum i parasheh asfaltimin e disa rrugëve në Komunën e Pejës në vlerë prej 1 milion e 400 mijë eurove. Projektet infrastrukturore komunale janë në kuadër të investimeve të reja që i ka paraparë Ministria e Infrastrukturës në vitin 2021, që janë gjithsejtë 33 projekte të reja.



GIZ-i dhuron material didaktik për nxënësit e dy qendrave mësimore për komunitetet joshumicë

PODUJEVË, 27 JANAR (ER) - Nën kryetarja e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, të mërkurën në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Ibrahim Rugova", pranuan një donacion nga GIZ-i gjerman për qendrat e mësimimit për fëmijë të komuniteteve joshumicë.

Donacioni i sotëm i dhuruar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për dy qendra mësimore për fëmijët e komuniteteve joshumicë në Podujevë, me

bazë në shkollat "Ibrahim Rugova" dhe "Shaban Shala", ka për qëllim avancimin e cilësisë së mësimnxënies dhe përmirësimin e kushteve të mësimimit për nxënësit e komuniteteve.

Donacioni i dhuruar nga GIZ-i, që u implementua nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), që përmban material didaktik (libra, fletore dhe materiale të tjera përcjellëse), do ta bëjë më atraktiv mësimin për këta fëmijë.

Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, ka thënë se donacionet janë

gjithmonë të mirëseardhura, sidomos kur kemi të bëjmë me arsimimin e nxënësve të komuniteteve jo shumicë. Ai shprehu gatishmërinë dhe përkrahimin e plotë të drejtorisë që udhëheq për përkrahjen dhe përmbushjen e nevojave të këtyre nxënësve.

Nën kryetarja Lahu dhe drejtori Fetahu falënderuan GIZ-in për këtë donacion dhe përkrahjen e vazhdueshme për arsimin në Komunën e Podujevës. Në ceremoninë me rastin e pranimit të donacionit ishte edhe kryetarja e Komitetit për



Komunitete në Komunën e Podujevës, Albina Avdiu dhe përfaqësues të komuniteteve joshumicë.

Parlamenti Evropian ndan certifikata për nxënësit e Drenasit



DRENAS, 27 JANAR (ER) - Parlamenti Evropian ka ndarë certifikata për nxënësit e Gjinnazit "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" të cilët ishin pjesëmarrës në konferencën e organizuar nga "Euroscola", bashkë me 94 shkolla të tjera të Bashkimit Evropian. Këto certifikata të PE-së janë pranuar nga kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz

Lladrovci, i cili të mërkurën në sallën e Kuvendit Komunal ua ka dorëzuar nxënësve pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare, duke u shprehur krenar dhe mirënjohës për suksesin e gjinnazistëve. Bashkë me këto certifikata lëvdatë për pjesëmarrjen e suksesshme të nxënësve të Drenasit, ata

pranuan edhe flamurin e Bashkimit Evropian. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, është shprehur krenar me punën e nxënësve, duke u zotuar për përkrahje të vazhdueshme dhe ndarje të një burse për nxënësit pjesëmarrës në konferencën nga "Euroscola" në Parlamentin Evropian.

Haziri e Kadriu nënshkruajnë memorandumin për efikasitet të energjisë

GJILAN, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar memorandumin mirëkuptimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, përkatësisht zëvendësministrin Rexhep Kadriu, për realizimin e projektit të ndërrimit të poçave elektrike, në kuadër të efikasitetit të energjisë elektrike.

Kryetari Haziri e ka falënderuar zëvendësministrin Kadriu për mbështetjen në këtë dhe projekte të tjera për Gjilanin. "Jam i lumtur që sot në Gjilan është zëvendësministri i Ekonomisë dhe Ambientit, ish-nën kryetari i komunës dhe miku im, Rexhep Kadriu. Në marrëveshjen e sotme të mirëkuptimit, Gjilani përfiton nga programi i për efikasitet të energjisë elektrike, për zonën urbane dhe rurale. Është një program i jashtëzakonshëm sepse ul kostot e shpenzimit dhe modernizon e standardizon infrastrukturën për ndriçim publik", ka thënë Haziri, pas nënshkrimit të këtij memorandumi.

Ndërsa zëvendësministri i Ekonomisë dhe Ambientit,

Rexhep Kadriu, ka bërë me dije se vlera e investimit të përbashkët e këtij projekti është 440 mijë euro. "Projekti ka të bëjë me ndërrimin e poçave elektrike në Komunën e Gjilanit, në qytet dhe fshatra. Janë rreth 3 000 trupa ndriçues të cilët do të ndërrohen në këtë fazë. Investimi nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është 308 mijë euro, ndërkaj nga



Komuna e Gjilanit është 132 mijë euro", ka thënë zëvendësministri Kadriu.

Ai ka thënë se ky nuk do të jetë projekti i fundit për Gjilan, duke shtuar se së shpejti do të ndërrohet gypi i ujësllësit që vjen nga Përplepnica në drejtim të Gjilanit. "Krejt këto projekte të mëdha të qeverisë për Gjilanin janë meritë e kryetarit Haziri, sepse falë angazhimit të tij të madh gjatë këtyre viteve, ka bërë që investimet qendrore ta kenë prioritet Gjilanin", ka deklaruar Kadriu.

QKMF-ja në Podujevë do të ofrojë shërbime të reja shtesë për qytetarët

PODUJEVË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Egzona Mustafa Gashi, kanë vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila për herë të parë do të ofrojë shërbim paliativ, kurse shërbimet e rëntgenit dhe të laboratorit qytetarët do të mund t'i marrin gjatë 24 orëve. Kryetari Bulliqi me këtë rast ka

thënë se që nga marrja e mandatit në krye të komunës një nga prioritetet kryesore të qeverisjes është përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve mjekësore për qytetarët e Podujevës. "Me ofrimin e shërbimit paliativ ofrojmë vizitën mjekësore dhe aplikimin e terapisë nga doktori i mjekësisë dhe infermieres në shtëpitë e të sëmurëve të cilët janë të palëvizshëm. Gjithashtu, me shërbimin gjatë

24 orëve të rëntgenit dhe laboratorit, qytetarët nuk do të kenë nevojë të shkojnë nëpër laboratorë privatë, por edhe në QKUK në Prishtinë, për të marrë këto shërbime", ka thënë Bulliqi.

Ai ka theksuar se Komuna e Podujevës do t'i vazhdojë investimet në sektorin e shëndetësisë, në mënyrë që qytetarët tanë të marrin shërbime mjekësore cilësore dhe të shpejta.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (12)

Aziz Kelmendi ishte njeri i drejtë dhe i edukuar kombëtarisht




Lulzim SAHITI

Eprori ushtarak Tafil Avdijaj në atë kohë ishte me gradën e togerit dhe shërbente në Kazermën e Leskovcit në Serbi. Përndryshe ishte epror ushtarak i Aziz Kelmendit, i cili ka rrëfyer hollësisht se si ishte njohur e takuar me të. Pastaj ka bërë përshkrimin e jetës ushtarake të Azizit gjatë trajnimit katërmujor në Leskovc dhe angazhimit të tij si përkthyes në procesin e Paraqinit: Në rrethanat e kohës unë kam shërbyer si oficer i APJ-së, kurse Azizi si rekrut në Garnizonin e Leskovcit. Ishte shtatori i vitit 1986, kur rrethanat dhe kushtet e shërbimit na takuan rastësisht në Leskovc. Unë në atë kohë u caktova në komisionin për pranimit dhe sistemimin e rekrutëve të rinj, të cilët vinin në shërbimin ushtarak në Garnizonin e Leskovcit. Në mesin e rekrutëve arriti edhe Azizi. Sipas procedurave në komision zhvillohej pranimi dhe sistemimi i rekrutëve. Pas bisedës së shkurtër me Azizit, me sa mbaj mend, ai kishte ardhur në ushtri i rekrutuar nga Sekretariati i KK Prizrenit dhe nuk kishte ndonjë pengesë apo evidencë për ndonjë vepër penale. E vërejtja se ai nuk e njihnte gjuhën serbokroate dhe vendosa që Azizit ta sistemoja pikërisht në njësinë time si pjesëtar i ekuipazhit të tankut, gjegjësisht shërbyes i mitralozit të tankut dhe kështu vazhduam për katër muaj njohjen dhe trajnimet, të cilat Azizi do t'i kryente në Leskovc. Me të përfunduar trajnimet themelore do të transferohej në Garnizonin e Paraqinit. Gjatë shërbimit të Azizit në Leskovc, ai në shikim të parë të linte përshtypje se ishte njeri serioz dhe paksa i ngrysur në vete. Ndoshta nga hallet, mundimet dhe ndjekjet që e kishin përcjell qysh në moshë të re, gjë që më vonë është marrë vesh pasi që ka ndodhur rasti i Paraqinit. Me kalimin e kohës e vërejtja se tek ky person ka shumë pozitivitet. Ai ishte i lexueshëm, recitonte poezi. Ishte kureshtar për të nxënë sa më shumë dije rreth armatimit, ku në shumë raste duke e zgjedhur me vëmendje

momentin e duhur kërkonte t'i përkthehen në gjuhën shqipe pjesët e armatimit. Ishte njeri i drejtë dhe i edukuar kombëtarisht. Ishte paksa temperament por shumë i kujdesshëm që mos të ofendonte ndokënd, ndërkaq padrejtësitë, ofendimet nuk i ka duruar. Dallonte nga moshatarët si më i pjekur dhe më i qëndrueshëm e më i vëmendshëm. Nuk ankohej për ndonjë vështirësi sa ishte në shërbim në njësinë time. Me sa mbaj mend të vetmin shqetësim dhe që i pengonte shumë ishte ushqimi në kuzhinë por kuptohej edhe kujdesi e mërziqja për familjen. Nuk mbaj mend që Azizi deri sa ishte në shërbim tek njësinë ime që është thirrur ndonjëherë në përgjegjësi për ndonjë shkelje apo bisedë informative nga shërbimi siç ndodhte në atë kohë me ushtarët shqiptar.

Ishte një ko incidencë, në ditën kur ka ndodhur rasti i Paraqinit, unë isha kujdestar në Kazermën e Leskovcit. Më kujtohet se rreth orës 4:00 të mëngjesit të hershëm të asaj dite, më kanë thirrur nga Garnizoni i Nishit, Komanda e Tretë e APJ-së së asaj kohe dhe kanë kërkuar dosjen e trajnimeve për Azizit dhe të dhëna të tjera për kohën sa ishte në Leskovc pa dhënë sqarime. Kur ju tregova se ai ishte ushtar i imi sepse ende e kisha në kujtesë, më kanë pyetur edhe një herë se si quhem dhe pas përgjigjes sime linja telefonike është ndërprerë menjëherë. Pas gjysmë ore isha i izoluar nga Policia Ushtarake dhe kanë filluar me marrje në pyetje për tri ditë radhazi në izolim të plotë.

Pas një muaji nga ngjarja e Paraqinit më kanë thirrur në Gjykatën e Ushtarake në Nish dhe më kanë angazhuar si përkthyes në rastin e Paraqinit. Angazhim im ishte bërë padashur si përkthyes vetëm në gjykatë e jo në hetimet tjera, të cilat i bënin jashtë gjykate deri në gjykimin kryesor. Prandaj, kam ardhur në përfundim se hetimet fillimisht janë zhvilluar për shkelje të shumta të procedurave nga ana e eprorëve dhe mosdisiplinës së tyre në Garnizonin e Paraqinit (ka pasur dënime të eprorëve për shkelje të rregullave) por me të marrë vesh se Azizi kishte tentuar të arratiset në Shqipëri, para se të vinte në shërbim ushtarak e ndryshojnë plotësisht rrjedhën e hetimeve dhe fillojnë montimin e Procesit të Paraqinit. Këtë përfundim e nxjerr bazuar në




Aziz Kelmendi

pyetjet që mi kanë parashtruar mua gjatë intervistimit tim, por edhe nga dokumentet që i kam parë sepse edhe Rizah Xhaklin fillimisht e kishin angazhuar si përkthyes në Paraqin gjatë vizitës së prindërve të Azizit. Por jo vetëm kjo po edhe me vet faktin se e ndërrojnë komplet ekipin e hetimeve, sjellin hetues nga Beogradi, e ndërrojnë gjykatësin hetues dhe e sjellin gjykesin hetues nga Beogradi, i arrestojnë të

gjithë ushtarët shqiptarë në Garnizonin e Paraqinit duke përfshirë edhe Islam Mahmutin, rom nga Gjakova, i cili ishte burgosur vetëm pse ishte shoqëruar me shqiptarë. Te arrestuar ishin: Riza Xhakli, Afrim Mehmeti (e kam njohur se edhe ky ishte në shërbim ushtarak në Leskovc), Abdylxhemil Alimani, Shefqet Paçarizi, Pajazit Aliu, Enver Behluli, Rizo Alibashiq, mysliman-boshnjak i Bosnjës

dhe Hercegovinës, të cilin e përfshinë për arsye se nuk kishin mundur me i ikë arrestimit të tij për arsye se ishte komandat roje në natën kritike në Paraqin. Për fund dua ta cek qëndrueshmërinë e djelmoshave të ri në moshë, të cilët i përballuan gjatë hetimeve një presioni tepër të madh siç ishin Abdylxhemil Alimani, Rizah Xhakli e Afrim Mehmeti. (Vijon)



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ylli triumfon kundër Prishtinës, Peja bindes ndaj Bashkimit

Skuadra e Yllit në kryeqytet e ka mposhtur Sigal Prishtinën, derisa Peja ishte skuadër shumë e fortë për Bashkimin. Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet tjera për këtë xhiro, kurse takohen Vëllaznimi-Trepça dhe Rahoveci-Ponte Prizreni

“Epoka e re”

PRISHTINË, 27 JANAR - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës në udhëtim 60:68 (14:12, 14:18, 15:18, 17:20), në kuadër të javës së 18-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja nisi e baraspeshuar dhe këtë e dëshmon edhe rezultati i çerekut të parë, 14:12. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periudhën e dytë, me therandasit që për një nuancë ishin më të mirë 14:18, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 28:30. Mysafirët e nisën më mirë periodën e tretë, duke pasur epërsi në nëntë pikë, 31:40, por prishtinasit nuk dorëzohen dhe barazuan shifrat në 43:43, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 43:48. 10 minutat e fundit ishin mjaft interesant. Bardhekaltrit kalojnë në epërsi 53:52, por Ylli shkëputet sërish në 55:63, me tetë pikë radhazi të Erjon Kastratit, pesë prej tyre nga gjuajtja e lirë. Therandasit ruajtën epërsinë deri në fund dhe triumfuan 60:68. Te Sigal Prishtina u dalluan Daniel Lekndreaj me 14 pikë e nëntë kërcime dhe Nigel Johnson me 22 pikë, kurse te Golden Eagle Ylli u dallua Erjon Kastrati me 26 pikë e nëntë kërcime. Sigal Prishtina ka pesë fitore dhe 13 humbje, kurse Golden Eagle Ylli 12 fitore dhe gjashtë humbje. Ndërsa Peja ka shënuar fitore bindëse ndaj Bashkimit 95:58 (26:17, 22:8, 21:17, 26:16), në kuadër të xhiros së 18-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Peja e nisi ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi deri në 17



pikë, 26:9, por më pas prizrenasit me një seri prej 0:8, ngushtuan shifrat në 26:7, sa përfundoi çereku i parë. “Verdhezinjtë” vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke thelluar edhe më shumë epërsinë, kurse pjesën e parë e përfunduan në të mirë të tyre 48:25. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periodën e tretë. Pejanët rritën epërsinë në 26 pikë, 53:27, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 69:42. Në 10 minutat e fundit u zhvilloja loja vetëm formalisht, kurse vendasit thelluan edhe më shumë epërsinë, duke triumfuar në fund 95:58. Te Peja u dalluan Brandon Walters me 18 pikë e 13 kërcime, Dion Dixon

me 19 pikë e shtatë asistime, Dardan Berisha me 19 pikë e gjashtë kërcime dhe Marko Peroviq me 15 pikë e tetë kërcime, kurse te Bashkimi, Endrit Hysenagolli me 13 pikë e 11 kërcime. Peja ka 12 fitore dhe gjashtë humbje, kurse Bashkimi nëntë fitore dhe nëntë humbje.

SUPERLIGA

Peja - Bashkimi 95:58
Sigal Prishtina - Ylli 60:68

Sot takohen:
15:00 Vëllaznimi - Trepça
17:00 Rahoveci-Ponte Prizreni

SHKURT

Anulohet ndeshja Drita - Nizhny Novgorod

FC Drita ka njoftuar se është anuluar ndeshja miqësore kundër skuadrës ruse Nizhny Novgorod. Kjo ndeshje ishte paraparë të zhvillohet të mërkurën nga ora 16:30, derisa do të zhvillohet sot (e enjte). “Për shkak të kushteve atmosferike ndeshja është anuluar dhe pritet të zhvillohet të enjten në të njëjtën kohë”, thuhet në njoftimin e skuadrës nga Gjilani.

Të dielën ndeshja e futbollit kushtuar dëshmorëve Pajaziti-Zejnullahu-Hoxha

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se për nder të dëshmorëve të kombit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, do të organizohet ndeshja revyale ndërmjet ekipeve të qyteteve, Podujevës dhe Prishtinës. Kjo e fundit vitin e kaluar ishte fituese e këtij trofeu. Ndeshja zhvillohet të dielën, më 31 janar, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, në orën 16:30. Para kësaj ndeshje, prej orës 16:00 zhvillohet një ndeshje e veteranëve të UÇK-së.

Sokoli: Dautaj dhe Dallku janë pjesë e Gjilanit

Qëndrim Dautaj dhe Ardin Dallku do të jenë pjesë e Gjilanit në stinorin pranveror. Këtë fakt për “Gazetën Olle” e ka konfirmuar edhe trajneri i SC Gjilanit, Bylbyl Sokoli. “Përgatitjet kanë shkuar shumë mirë, kemi edhe shumë punë për të bërë ende, por me rëndësi është se të gjithë futbollistët po japin maksimumin për ta gjetur formën dhe për të qenë gati. Dallku dhe Dautaj nuk kanë qenë në prova siç aludohej, ata janë anëtarë të Gjilanit dhe kanë treguar formë shumë të mirë në këto ditë”, ka thënë Sokoli.

Xhaka: Ta vazhdojmë këtë ecuri në ligë

Arsenali e bëri edhe një hap tjetër drejt topkatërshes, duke e mposhtur të martën 3-1 Southamptonin. Arsenali është vetëm pesë pikë larg vendit të katërt tani, i cili mbahet nga West Hami tani për tani. Mesfushori i Zvicrës, me prejardhje nga Kosova, Granit Xhaka, luajti rol edhe në këtë triumf si në gjashtë fitoret e kaluara, duke kontribuar me një asistim. “Tri gola dhe tri pikë. Tani ta vazhdojmë këtë ecuri në ligë”, ka shkruar Xhaka.

Më 5 shkurt shpallen Laureatët e Vitit 2020 në hendboll

PRISHTINË, 27 JANAR - Bordi i Federatës i Hendbollit i Kosovës, nën drejtimin e presidentit Eugen Saraçini, ka mbajtur mbledhjen e parë për këtë vit. Janë marrë vendime shumë të rëndësishme për hendbollin e Kosovës. Kështu, laureatët e vitit 2020 do të shpallen më 5 shkurt. Komisioni për shpalljen e laureatëve

përbëhet nga Shqipe Bajçinca-Brestovci, Leonard Cula e Fahredin Hashani. Në mbledhje u shqyrtua dhe u miratua raporti financiar për vitin 2020. Raporti u miratua me vetëm një votë kundër. Bordi, po ashtu, miratoi edhe materialet e punës për Kuvendin Zgjedhor të FHK-së që mbahet më 5 shkurt. Bordi, në

bazë të së drejtës statutare, nominoi Eugen Saraçinin për një mandat tjetër si president, Enis Idrizin për nënpresident dhe Bajram Isufin, Berat Danën e Artan Nimanin për anëtarë të bordit. Bordi vlerësoi se periudha e kaluar katërvjeçare ishte më e mira e punës dhe e afirmimit të hendbollit të Kosovës.



Gjysmëfinale interesante në Kupën e Kosovës

PRISHTINË, 27 JANAR - Sot (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshjet gjysmëfinale në Kupën e Kosovës në konkurrencën e femrave. Përballja e parë do të jetë ndërmjet Vëllaznimit dhe

Prishtinës. Skuadra kuqezi ka treguar ndeshje dhe rezultate të mira në këtë edicion, kurse prishtinaset kanë ambicie të mëdha dhe synojnë të kualifikohen në finalen e madhe. Sfidat tjetër do të jetë

ndërmjet Bashkimit dhe Penzës. Këto dy skuadra u përballën edhe në fundjavë në Superligën e Femrave, ku fitoi shënoi skuadra prizrenase 85:74. Ndeshja do të jetë mjaft interesante, sepse të dyja

skuadrat kanë bërë përf forcime për stinorin pranveror. Finalja e madhe do të zhvillohet më 7 shkurt në Suharekë. Të enjten takohen: Vëllaznimit-Prishtina (17:30) dhe Bashkimi-Penza (19:00).



Bahtiri nderon me mirënjohje anëtarët e Klubit të Zhytjes 'Trepça'

MITROVICË, 27 JANAR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka prituri në takim kryetarin e Klubit të Zhytjes "Trepça", Liridon Ahmeti, së bashku me anëtarët e tjerë të këtij klubi. Qëllimi i këtij takimi ishte ndarja e mirënjohjes dhe shprehja e falënderimit ndaj Klubit të Zhytjes "Trepça" për kontributin dhe punën profesionale e të palodhshme, që vazhdojnë të kryejnë ndër vite në të mirë të qytetit dhe të qytetarëve të Mitrovicës. Me këtë rast, Bahtiri është shprehur tejet mirënjohës ndaj të gjithë anëtarëve të këtij klubi për mbështetjen që kanë dhënë për komunën, si dhe gatishmërinë e tyre për t'i ndihmuar qytetarët çdoherë kur ka pasur nevojë për intervenime urgjente, duke potencuar evakuimin e disa familjeve në lagjen "2 Korriku" dhe në fshatin Lisicë gjatë kohës kur u përfshinë nga



vërshimet. Po ashtu, ai ka përmendur edhe pastrimin e Liqenit Akumulues disa herë klubi në fjalë e ka mbështetur komunën në këtë drejtim dhe pa hezitim kanë larguar tërësisht barishtet nga hapësirat ujore, si dhe ndihmën e dhënë shpeshherë në shpëtimin e jetëve të qytetarëve. Ndërsa Liridon Ahmeti nga Klubi i Zhytjes

"Trepça" ka falënderuar kryetarin Bahtiri për mikpritjen dhe përkrahjen e tij dhe të komunës, ku ka theksuar se mirënjohja e ndarë të mërkurën nga Komuna e Mitrovicës do t'i motivojë të gjithë zhytësit që edhe në të ardhmen të japin kontributin e tyre, e të jenë gjithmonë në gjendje gatishmërie në rastet e rrezikut.

Katër skenarë për mbajtjen e Lojërave Olimpikë

LOZANË, 27 JANAR - Më 4 shkurt, në Lozanë, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) do t'i paraqesë zyrtarisht rregullat anti-Covid që do të zbatohen gjatë Lojërave Olimpikë "Tokio 2020". Rregulla që do të zbatohen nga mbi 15 mijë sportistë (olimpikë dhe paraolimpikë) dhe mijëra trajnerë, mjekë, gazetarë e staf që do t'i shoqërojnë ata. Lojërat Olimpikë do të nisnin më 23 korrik.

Lucia Montanarella, një nga zëdhënëset e shtypit të IOC-së, ka thënë: "Kemi krijuar katër skenarë të ndryshëm për këtë olimpiadë. Një prej tyre është i ngjashëm me atë që po kalojmë sot, me pandeminë që është ende mes nesh dhe me disa shtete që nuk janë në gjendje ta kontrollojnë dot atë. Të gjithë ata që do të vijin në Japoni për Olimpiadën, me shumë gjasa, do të kryejnë një periudhë karantine në vendet e tyre para se të nisen për në Japoni. Më pas, do ta



zhvillojnë testin në aeroportin e vendit të tyre para se të nisen dhe test menjëherë pasi të mbërrijnë në Tokio. Testet të shpeshta do të kryhen edhe në Fshatin Olimpik", ka shtuar Montanarella.

Ky i fundit ka njoftuar se IOC ka kërkuar që sportistët që do të shkojnë në Olimpiadë të vaksinohen, por OBSH-ja nuk e pranon këtë gjë. "Kjo është një sfidë e madhe, pasi nuk do të

krijojmë një vend të sigurt për 200 sportistë, por për mijëra sportistë. Ne si IOC kemi ngritur zërin që sportistët që do të shkojnë në Olimpiadë të vaksinohen edhe pse OBSH nuk e pranon këtë gjë, pasi nuk e konsideron si një grup vulnerabel dhe që rrezikon. Ne shpresojmë të kemi edhe tifozë, pasi Japonia ka investuar shumë dhe ka nevojë për praninë e tyre", ka deklaruar Montanarella.

Erikseni vulosin fituesin e ndeshjes Inter-Milan: Për mua, ishte gjuajtje e përkryer

Mesfushori i Interit, Christian Eriksen, ka folur pasi ishte vendimtar në fitoren ndaj Milanit në Kupën e Italisë. "Neurazzurët" fituan me

rezultat të ngushtë 2-1, derisa "Rossonerët" ishin me 10 lojtarë në fushë, pas kartonit të kuq të Zlatan Ibrahimoviçit. Danezi që shënoi supergol nga gjuajtja e

lirë tha se është vërtet i lumtur. "Për mua, ishte gjuajtje e përkryer. Jam shumë i lumtur. Gjithmonë kam shikuar në minutat që kam dhe jam i

lumtur që kam shënuar nga gjuajtja e lirë. E dinim që do të ishte ndeshje e vështirë, intensiteti është i lartë në derbi. Ishte vështirë, por të lumtur që

do të arrijmë në raundin tjetër", ka thënë Eriksen, i cili golin ia ka dedikuar vajzës së porsalindur, familjes dhe të gjithë tifozëve.

SHKURT

NBA në mars mendon organizimin e 'All Star Game'

Ndeshja e njohur e "All Star Game" e vitit 2021 në NBA, e planifikuar për t'u organizuar në Indianapolis, është zyrtarisht e anuluar dhe shtyrë për vitin 2024. Gjithsesi, NBA po mendon që ndeshjen e famshme të yjeve të basketbollit ta zhvillojë më 7 mars në Atlanta. Më datat 5-10 mars, NBA do të jetë pushim dhe drejtuesit po analizojnë idenë për ta organizuar këtë ndeshje gjatë asaj fundjave. Si NBA ashtu dhe Shoqata e Lojtarëve po diskutojnë këtë ide. Nuk ka për të qenë e lehtë për të gjetur një marrëveshje, duke ditur që deri më tani janë anuluar 22 takime të këtij sezoni për shkak të pandemisë Covid-19. Natyrisht se kjo ndeshje do të zhvillohet nën masa të rrepta sigurie dhe duke zbatuar protokollin anti-Covid të NBA-së dhe mbi të gjitha do të luhet pa tifozë.

Edhe Sandro mposhti koronavirusin

Alex Sandro ishte lojtari i fundit i skuadrës së parë të Juventusit që vazhdonte të ishte pozitiv për Covid-19. Pas lajmit të shërimit të De Ligt e Cuadrado, sot vjen edhe radha e brazilianit. Latini u është nënshtruar dy testeve të njëpasnjëshme dhe ka rezultuar negativ, duke konfirmuar shërimin e plotë nga Covid-19. Lajmin e mirë e njofton vetë klubi bardhezi përmes një postimi në rrjetet sociale, duke bërë të ditur se mbrojtësi iu bashkua skuadrës në stërvitjen e së mërkurës.

Arsenali transferon Odegaardin

Martin Odegaard është tashmë lojtar i ri i Arsenalit, deri në fund të sezonit, pasi klubi londinez zyrtarizoi huazimin deri më 30 qershor. "Topçinjtë", të cilët nuk do të kenë asnjë mundësi blerjeje të norvegjezit, siç ndodh, për shembull, me Dani Ceballos, krijojnë një mesfushë që Arteta e ka kërkuar me muaj për ta pasur. Largimi i Ozilit të Fenerbahçe e ka lehtësuar operacionin, sepse është reduktuar fatura e pagave të ekipit.

Pioli: Diferencën e bëri kartoni i kuq i Ibras

Interi arriti ta përmbysë Milanin këtë mbrëmje dhe të fitojë me shifrat 2-1, duke siguruar kalimin në gjysmëfinale të Coppa Italia, pas një ndeshje plot episode dhe emocione. Pas ndeshjes foli trajneri i kuqezinjve, Stefano Pioli foli për mediat dhe u shpreh i kënaqur me ekipin e tij dhe i vetmi episod që bëri diferencën ishte kartoni i kuq i Ibrahimoviçit. "Është zhgënjyese që jemi eliminuar sepse u kujdesëm për këtë ndeshje. Kjo ndeshje tregoi se jemi ekip i fortë, që mund të qëndrojmë mirë, por kartoni i kuq na e bëri shumë të vështirë. Sherri Lukaku-Ibra? Ajo situatë kishte ndikim sepse shkaktoi kartonin e parë të verdhë e më pas të dytën. Ata janë të dy të rritur, i thanë diçka njëri-tjetrit, nuk e di çfarë. Gjëra që ndodhin, të shohim përpara", ka thënë Pioli. "Ndikoi shumë fakti që ishim me 10 vetë, u bë e komplikuar dhe ishim naivë në faullin e shkakuar për penalltinë. Sidoqoftë pas kësaj humbje unë ndihem shumë më pozitiv dhe i sigurt se pas ndeshjes me Atalantan. Ishte një ndeshje shumë e ekuilibruar, diferencën e vetme e bëri fakti se ishim me një lojtar më pak. Nëse do të ishte 11 kundër 11, ndeshja ishte e hapur për çdo rezultat dhe ne ishim 1-0 në avantazh. Kartoni i dytë i verdhë i Ibras ishte nga dëshira e tij për ta ndihmuar skuadrën dhe për ta ndihmuar ekipin. Ai mund të ishte ngadalësuar, por ndodh", përfundoi Pioli.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Nr.02

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212), nenit 4 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, Vendimit Nr. 06 të datës 27.01.2021 dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 27.01.2021 vendosi që të shpallë :

Konkurs publik

Për këtë pozita

I. 1 /një/ SHOFER me "C1E" kategori, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 3/tre/ vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Kushtet:

Të posedojnë nivelin e edukimit të mesëm, Patentë shoferi me "C1E" kategori, të ketë më së paku 1 (një) vite përvojë të punës relevante, dhe të mos jetë i dënuar ose nën hetime .

Kushtet e veçanta:

Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Varësisht nga performanca e tij do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca-Përvojë 1 (një) vitë në punët relevante, Patentë Shoferi me "C1E" kategori dhe Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më e re se gjatë muaj).

Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin me rimorkio dhe kujdeset për rregullsinë, higjienën dhe pastërtinë e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona) tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-koordinatorit të autoparkut;
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencon punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet dhe të njëjtën e kthen te koordinatori i autoparkut;
- Vendos (monton) letrën e re të Tahografit ndërsa letrën paraprake e kthen te udhëheqësi, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e Tahografit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhin fillestar dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshesat etj.), për ekipin e punëtorëve me të cilët punon,
- Largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësën e punës;
- Në rast nevojë ndërron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmëron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshëm apo mungesë nga procesi i punës, të punëtorëve me të cilët punon, vozitësi është i obliguar ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejt brenda orarit të punës.
- E njofton udhëheqësin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër;
- Pas përfundimit të orarit të punës bënë pastrimin (larjen) e automjetit të punës dhe e parkon në vendin e caktuar; dhe
- Kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Paga: Përcaktohet nga Punëdhënësi në lartësinë e nivelit të vendit të punës.

Afati i paraqitjes së kërkesave është 15 ditë nga data e publikimit, (nga data 27.01.2021 e deri me datë 10.02.2021 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit (ngasjes) dhe intervistës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiilan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës neni 5 pika c, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr 07/2017, për Rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Gjiilan shpallë këtë :

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS Rishpallje

1. SHFMU "Afërdita" në Kishnapole

- Një mësimdhënës/e i lëndës së fizikës 14 orë në Kishnapole dhe Sllakove

2. SHFMU "Feta Qerimi" në Vërbicë të Zhegocit

- Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës angleze 10 orë, pushim pa pagesë deri 30.09.2021
- Një mësimdhënës/e i lëndës së fizikës me 16 orë, në paralelen e ndarë Zhegoc deri më 31.08.2021

3.SHFMU e Muzikës

- Dy mësimdhënës/e për lëndën Kitarë, njëri me 20 orë dhe tjetri me 10 orë deri me 31.08.2021

4. SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Livoq të Poshtëm

- Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës gjermane me 8 orë, plotësim norme në SHFMU "Afërdita" me 7 orë, deri me datën 31.08.2021

II Shkolla e Mesme e Lartë (SHML)

1.SHMGjinnazi "Zenel Hajdini" në Gjiilan

- Një mësimdhënës/e i lëndës së artit , pushim i lehonisë deri më 31.03.2021

Vërejtje: Kontratat e punës përveç atyre që janë pushim i lehonisë dhe pushim pa pagesë lëshohen deri më 31.08.2021. Pas skadimit të këtyre kontratave që lëshohen deri me 31.08.2021 për këto vende të punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në cilësinë e punëdhënësit do të bëjë një analizë të tepricave të mësimdhënësve që mund të ketë për vitin shkollor 2021/2022, në rast se nuk paraqiten teprica të mësimdhënësve, nëpunësve të pranuar do t'iu vazhdohet kontrata e punës në ato shkolla.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT (UA Nr.10/2018) ,Udhëzimin Administrativ MASHT, nr.05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe procedurave të përcaktuara për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kualifikimi për Edukatorë/e dhe Mësimdhënës/e: kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 12/2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më 28.01.2021 deri më datë 11.02.2021 (ora: 16:00).

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet në fuqi. Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuar të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiilan. Kandidatët të cilët aplikojnë më shumë se një shkollë, mund të aplikojnë vetëm me një formularë të aplikimit duke i cekur emrat e shkollave ku aplikon.

Sqarim:

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar.

Vërejtje: Për shkak të rrethanave të Pandemisë – Covid 19, Testi me shkrim dhe Intervista me gojë do të realizohen sipas Rekomandimeve dhe Udhëzimeve të IKSH (Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik) dhe MSH (Ministritë së Shëndetësisë).

Drejtori:
Nazim Gagica



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndrëtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Njomza Osman Kuçi shpall të pavlefshme diplomën e bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

► Viktoria Asllan Bytyçi shpall të pavlefshme diplomën bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

► Festim Qelavet shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Agim Rama shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Velija Rejhan shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shf "Shari" Jabllanicë.

► Vilman Qovanaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren .

Ahmet Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Fadil Hisari" Prizren.

► D.P.Z. "Trevira-D" Daut Bajgora shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 600882014.

► Fatmir Shahini, B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr. 330091968 Gjilan.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188


Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr- 315
Me datë 25.01.2021
Në bazë të nenit 8.të paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr- 03/L-212, nenit 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ(MPMS)nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Autorizimit të Kryetarit të Komunës,01-Nr.016-4085 të datës 18.01.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bënë :

KONKURS

1.Një mjek/e të praktikës së përgjithshme në QKMF-së në Suharekë.

Numri i Referencës: 06- Nr. 315

Përshkrimi i punës dhe detyrave të punës :

- Kujdeset për shëndetin e pacientëve,përshkruan tretmanet,medikamentet dhe aplikon masat tjera shëruese;
- Udhëzon pacientët në bërjen e analizave bazike laboratorike dhe aplikon procedurat tjera diagnostike;
- Aranzhon bartjen e pacientëve në spital;
- Udhëzon pacientët tek specialistët mjekësor dhe shkëmben të dhëna relevante mjekësore;
- Pranon implimentimin e programeve shëndetësore të dizajnuara në nivele më të larta si Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna;
- Ndihmon në preventimin e sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve të ndryshme duke u kështilluar në shëndetin bazik të përgjithshëm.j.
- Kualifikimi : Të gjithë kandidatët duhet të kenë të kryer fakultetin e Mjekësisë,drejtimi i Mjekësisë së përgjithshme.
- Orari i punës: 1 plot;
- Paga: H-27,H-565/1
- Kohëzgjatja 6 gjasht muaj punë me mundësi vazhdimi

Kandidatët që aplikojnë duhet të sjellin këto dokumente;

- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer;
- Vërtetimin mbi stazhin e kryer;
- Licencën e punës;
- Çertifikatën e lindjes;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën e gjendjes shëndetësore.
- Çertifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Suharekë.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe M.Sociale
Ma.Sc.Besa KUQI




Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr- 316
Me datë:25.01.2021
Në bazë të nenit 8.të paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr- 03/L-212, nenit 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ(MPMS)nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Autorizimit të Kryetarit të Komunës,01-Nr.016-4085 të datës 18.01.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë :

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës:

- Një Mjek/e Specialist/e të Gjinekologjisë.
- Kohëzgjatja e kontratës : Sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212/Për periudhë të pacaktuar(puna provuese 6 muaj).
- Orari i punës : 40 orë në javë.
- Koficienti: Gr./H-Doktor-specialist H-659/1
- Vendi i punës: QKMF- Suharekë
- Mbikëqyrja: Drejtori i QKMF-së
- Detyrat dhe Përgjegjësit:**
- Kryen egzaminime profesionale në lëminë e gjinekologjisë konform standardeve të mjekësisë bashkohore në Shëndetësinë Primare
- Përcjell zhvillimin e shtatëzanisë dhe shëndetin e gruas.
- Këshillosh pacientin për qështje shëndetësore me qëllim të uljes së rrezikut të sëmundjes.
- Punon në zhvillimin për planifikim familjar dhe mbrojtjen nga sëmundjet transmiseve.
- Kryen vizita gjinekologjike,cakton diagnozën dhe aplikon terapinë e nevojshme.
- Kryen egzaminime me qëllime diagnostike si:marrja e materialit për papa Test,egzaminime me ultratingull dhe egzaminime tjera.
- Kryen veprime edukativo-shëndetësore për gratë në fazën reproduktive.
- Këshillosh pacientet dhe aplikon terapi për sëmundje seksualisht transmiseve.
- Referon pacient në bazë të nevojës në shërbimet sekondare dhe terciare.
- Mban evidencën e nevojshme në protokollet përkatëse.
- Ndjek në vazhdimësi aktivitetet e ndryshme të ndërlidhura me zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
- Është e obliguar të respektohet kodi i veshjes.
- Kryen edhe punë tjera nga lëmia përkatëse.
- Kushtet dhe Kriteret:**
- **Kandidatët që konkurojnë duhet të sjellin këto dokumente:**
- Diplomën e Fakultetit i Mjekësisë,Spec.i Gjinekologjisë.(diplomën)
- Diploma e noterizuar
- Licencën e punës
- Çertifikatën e lindjes
- Fotokopjen e Letërnjoftimit
- Çertifikatën e gjendjes shëndetësore
- Çertifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetime
- Informatat e përgjithshme për të gjithë kandidatët;
- Kandidatët do të nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë.
- **Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve**
- Fletëaplikacionet merren në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe M.Sociale
Ma.Sc.Besa KUQI



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit
06. Br.315
Datum: 25.01.2021
Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru Opštine, 01-Br.016-4085 od 18.01.2021, Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu objavljuje:

KONKURS

1. **Jedan lekara opšte prakse C**
Naznaka broj: **06- Br. 315**

Opis poslova i radnih obaveza:

- Stara se o zdravlju,opisuje tretmane, lekove, i preuzima ostale mere za zdravstvenu negu pacijenata;
- Upućuje pacijente na osnovu laboratorijske analize i primenjuje ostale dijagnostičke procedure;
- Organizuje prenos pacijenata u bolnicu;
- Upućuje pacijente kod lekara specijaliste i razmenjuje relevantne medicinske podatke;
- Prihvata sprovođenje zdravstvenih programa sastavljenih na višim nivoima, kao Ministarstvo Zdravlja i Opštine;
- Pomaze u prevenciji zarazne bolesti i razne poremećaje u skladu sa osnovama opšteg zdravstvenog stanja itd.

Kvalifikacije: Svi kandidati moraju imati završen Medicinski Fakultet – smer Opšte Prakse;


- Puno radno vreme ;
- Plata : H-27,H-565/1
- Trajanje ugovora : 6 meseci probno sa mogućnosti produženja.

Kandidati koji konkurišu moraju doneti sledeću dokumentaciju :

- Diplomu o stručnom obrazovanju;
- Potvrdu da je završio/la praksu;
- Licencu za rad;
- Izvod rođenih;
- Fotokopiju lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrdu da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.

Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispele po isteku roka, neće biti razmatrane.
Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i ženskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.
Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkciji za Zdravstvo u Suvoj Reci.
Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim sredstvima javnog informisanja.

Direktor Direkcije, OCPM
Ma.Sc.Besa KUQI



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
06-NR-316
Datum: 25.01.2021 godine
Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru, , 01-Br.016-4085 od 18.01.2021, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:

KONKURS


- Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru, , 01-Br.016-4085 od 18.01.2021, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:
- Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru, , 01-Br.016-4085 od 18.01.2021, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:
- Za popunu slobodnog radnog mesta:
Jedan lekar/ka Specijalista ginekologije .
Trajanje ugovora: Prema Zakonu o radu br.03 / L-212 / na neodređeno vreme (probni rad 6 meseci).
Radno vreme: 40 sati nedeljno.
Koficijent: Gr./H-Lekar-specialista H-659/1
Radno mesto : OCPZ – Suva Reka
Nadzor: Direktor OCPZ
Poslovi i odgovornosti:
Vrši profesionalna ispitivanja iz oblasti ginekologije u skladu sa atandardima savremene medicine u primarnom zdravstvu.
- Prati razvoj trudnoće i zdravlje žena.
- Savetuje pacijenta o zdravstvenim pitanjima kako bi se umanjio rizik od bolesti.
- Radi na razvoju porodičnog planiranja i zaštu od prenosivih bolesti.
- Vrš ginekološke preglede, postavlja dijagnozu i primenjuje potrebnu terapiju.
- Obavlja preglede u dijagnostičke svrhe, kao što su uzimanje materijala za Papa test, ultrazvučni pregledi i drugi pregledi.
- Obavlja edukativne zdravstvene aktivnosti za žene u reproduktivnoj fazi.
- Savetuje pacijente i primenjuje terapiju za seksualno prenosive bolesti
- Upućuje pacijente na osnovu potreba u sekundarnim i terciarnim službama.
- Vodi potrebne zapise u odgovarajućim protokolima.
- Kontinuirano sprovodi različite aktivnosti vezane za kontinuirani profesionalni razvoj.
- Obavezno se pridržava kodeksa oblačenja.
- Obavlja i druge aktivnosti iz odgovarajuće oblasti.
- Uslovi i pravila:

Kandidati koji konkurišu moraju doneti sledeću dokumentaciju :

- Dipl.Medicinskog fakulteta, spec. Ginekologije.
- Notarizovana diploma
- Licenca rada.
- Izvod rođenih;
- Fotokopiju lične karte
- Zdravstveno uverenje.
- Potvrdu da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.
- Opšte informacije za sve kandidate:
- Kandidati će proći pismeni test i usmeni razgovor.
- Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u medijima i na oglasnoj tabli.
- Obрасci prijave se primaju u Direkciji Zdravstva i Socijalne Zaštite
- Nekompletirane prijave neće se razmatrati.

Direktor:
Ma.Sc.Besa KUQI

Në kujtim të më të dashurës sonë



AJNE BYTYQI - GASHI

(15.04.1938-17.01.2021)

Shpirtbardhë, synuat gjatë gjithë jetës ta mbani në çdo lëmi dhe në modesti të madhe ndërruat jetë por nuk do të vdisni kurrë edhe ashtu siç keni lindur për të mos vdekur kurrë.

Këta njerëz të mëdhenj i dëshiron zoti që dinë ta shohin tjetrin-ën si vetë vetën. Mirëpo pika-pika mbushet pusi-pusi ua mbylli sytë ndaj veprimtarisë suaj. Megjithatë vepra juaj na mbanë gjallë në çdo fushë të jetës që nga kjo pasqyrë kemi qenë dhe do të jemi krenar për autoritetin tënd. Andaj të përkujtojnë fëmijët dhe rejat si dhe nipa e mbesa në çdo moment për përhershmeri e ndriçueshmja Ajne Gashi-Bytyqi që urojmë shpirti, juaj në dritë të madhe!

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

